



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/dq-22483/me dt. 17. 11. 2023
122

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, në bazë të vendimit me nr. 14-670/02-211179/23, dt. 25.10.2023 për ndarjen e bursave për shpresat e sportit të Komunës së Prishtinës, si dhe në bazë të thirrjes për anëtar/e të jashtëm nr. 16-030/01-212111/23, dt. 27.10.2023, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET** Vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për shpresat e sportit të Komunës së Prishtinës.

II. Anëtarët e komisionit të cekur si në piken I të këtij vendimi janë:

1. Bardh Avdiu, Zyrtar i Lartë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues;
2. Vjollca Rexhepi - Morina, Zyrtare Ligjore, Anëtare;
3. Kastriot Orana, Anëtar i Jashtëm;
4. Mentor Dragusha, Zyrtar për Financa, Anëtar rezervë;

III. Detyrat dhe punët e komisionit të cekur në piken II të këtij vendimi, është vlerësimi i kërkesave duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Vendimin nr. 14-670/02-211179/23, dt. 25.10.2023, për ndarjen e bursave për shpresat e sportit të Komunës së Prishtinës, si dhe publikimi i listës së përfituesve të bursave.

IV. Për kryerjen e detyrave si në piken III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Kryeqytetit.

V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

I DOREZOHET :

- Anëtareve të Komisionit;
- Drejtorisë për Sport;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

